



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr. 50, datë 11.06.2020

PËR
MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË SHPALLJES SË EMERGJENCËS MJEDISORE
NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE NË TERRITORIN
E BASHKISË DURRËS PËR SHKAK TË MBYLLJES SË VENDDEPOZITIMIT TË
PORTO-ROMANOS

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, Ligjit nr. 10431, datë 09.07.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 967, datë 25.10.2013, pika 4/c “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 27.05.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035”, Vendim i Këshillit Kombëtar të Territorit nr.06, datë 13.01.2020 “Për miratimin e lejes së infrastrukturës: Mbyllja e venddepozitimit të mbetjeve të ngurta dhe ndërtimi i ECO-PARK Durrës” me vendndodhje në Bashkinë Durrës”, Vendim i Këshillit Kombëtar të Territorit nr.01, datë 13.01.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta” si dhe sipas relacionit të përgatitur nga drejtoritë e Bashkisë Durrës, në Bashkinë Durrës me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e propozimit të emergjencës mjedisore në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve në territorin e Bashkisë Durrës, për shkak të mbylljes së venddepozitimit të Porto Romanos.

2. Të kërkohet mbështetja financiare si dhe zëvendëskryetarit të Bashkisë, që kryen funksionet e kryetarit të Bashkisë, t'i jepet e drejta të bashkëpunojë me institucionet e qeverisjes qendrore, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare, Ujësjellës, Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve dhe Koncesionarin e Zonës së Trajtimit të Mbetjeve Tiranë, për gjetjen e një zgjidhjeje të menjëhershme dhe efikase për depozitimin e mbetjeve dhe zgjidhjen e situatës emergjente të Bashkisë Durrës në mbështetje të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr.01, datë 13.01.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta”.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).




KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 11.06.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 513 / Prot.

Durrës, më 11.06 2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 50, datë 11.06.2020 Për miratimin e propozimit të shpalljes së emergjencës mjedisore në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve në territorin e Bashkisë Durrës për shkak të mbylljes së venddepozitimit të Porto-Romanos”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që më jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
ROLAND NASTO

